

VENDIM
I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË TREGTARE
“Fundway Properties” L.L.C.

Sot, më, **25.06.2026**, unë i nënshkruari **Artan Lahaj**, në cilësinë përfaqësuesit të autorizuar të shoqërisë **“Fundway Holding” L.L.C.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës pranë regjistrimit tregtar të mbajtur nga Agjencia e regjistrimit të bizneseve të Kosovës me numër unik identifikimi 812421022 dhe me seli në Rrugën “Perandori Justinian” Nr. 69, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e cila vepron në cilësinë e **Ortakut të Vetëm** të shoqërisë **“Fundway Properties” L.L.C.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës, pranë regjistrimit tregtar të mbajtur nga Agjencia e regjistrimit të bizneseve të Kosovës me numër unik identifikimi 812425876 dhe me seli në Rrugën “Perandori Justinian” Nr. 69, Prishtinë, Republika e Kosovës (këtu e më poshtë referuar si **“Shoqëria”**), në ushtrim të kompetencave të Ortakut të Vetëm dhe të organit vendimmarrës të Shoqërisë, në emër dhe për llogari të Shoqërisë, vendosa si më poshtë vijon.

VENDIM

1. Hapja e një dege në Shqipëri

Shoqëria vendos të hapë një degë të saj në Republikën e Shqipërisë, me emrin e regjistruar **“Fundway Properties” L.L.C. – Dega në Shqipëri** dhe emër tregtar **Fundway Properties LLC**. (këtu e në vijim referuar si **“Dega”**).

2. Objekti

2.1 Dega do të ketë si objekt kryesor të veprimtarisë së saj zhvillimin e projekteve ndërtimore, si dhe të gjitha aktivitetet që lidhen me ndërtimin dhe pasuritë e paluajtshme, duke përfshirë në veçanti: ndërtimin e ndërtesave për banim dhe jo për banim; përgatitjen e sheshit të ndërtimit; instalime të tjera në ndërtim; instalimin e zdrëktuarisë; veshjen e dyshemeve dhe të mureve; lysterjen dhe xhamllëkun; përfundimin dhe finalizimin e ndërtesave; administrimin e pasurive të paluajtshme me tarifë ose me kontratë; dhënien me qira dhe shfrytëzimin e pasurive të paluajtshme në pronësi ose me qira; blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme në pronësi; si dhe veprimtaritë konsulente në fushën e biznesit, të menaxhimit dhe të inxhinierisë.

2.2 Për të realizuar qëllimin e mësipërm, Dega mund gjithashtu të:

- ushtrojë çdo veprimtari që lidhet me aktive të prekshme dhe të paprekshme, si edhe veprimtari tregtare, dhënie me qira ose hipotekim, që mund të konsiderohen të përshtatshme ose të nevojshme për realizimin e objektit të Degës;
- të blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, që mund të konsiderohen të përshtatshme ose të nevojshme për realizimin e objektit të Degës; dhe



- të kryejë çdo veprimtari tjetër që mund të konsiderohet e përshtatshme ose e nevojshme për realizimin e objektit të Degës.

2.3 Dega mund të ushtrojë gjithashtu çdo aktivitet tjetër tregtar apo veprimtari që konsiderohet e përshtatshme ose e dobishme për t'u zhvilluar në lidhje me ndonjë nga objektet e mësipërme, ose që është e aftë të rritë vlerën, ose të bëjë më fitimprurëse veprimtarinë, pasurinë apo të drejtat e Degës, në përputhje me legjislacionin shqiptar; dhe, në përgjithësi, të kryejë çdo veprim tjetër që Degës i duket i nevojshëm apo i dobishëm për arritjen e objekteve të mësipërme, ose ndonjërit prej tyre.

3. Selia e Degës

3.1 Selia e Degës do të jetë në: **Vlore Vlore Porti Detar Vlore, Blloku B2&C3 Vlore 9400**

4. Kohëzgjatja

Dega do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar.

5. Administratori

Administrator (përfaqësues ligjor) i Degës emërohet:

- Z. Artan Lahaj, i lindur më **10.05.1978** në **Gjakovë**, shtetas **Kosovar**, me numër identiteti/pasaporte **P01376087**.
- Z. Labinot Ajeti, i lindur më **19.05.1987** në **Prishtinë**, shtetas **Kosovar**, me numër identiteti/pasaporte **P01051155**.

Detyrat dhe kompetencat e Administratorit parashikohen në këtë Vendim, në aktet e Shoqërisë dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi. Administratori do të ushtrojë të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e administratorit pa kufizim dhe do të përfaqësojë Degën përpara të tretëve, institucioneve publike e private dhe autoriteteve në Republikën e Shqipërisë.

6. Aktet dhe dokumentet për regjistrimin e Degës

Aktet dhe dokumentet e nevojshme për regjistrimin e Degës do të hartohen në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe mund të nënshkruhen e depozitohen, në përputhje me paragrafin 7 më poshtë, nga çdo përfaqësues i autorizuar në to.

7. Përfaqësimi ligjor për regjistrimin e Degës dhe të pronarëve përfitues

Autorizimin e z. Erlind Kodhelaj me numër identifikimi personal I31014003E për të kryer regjistrimin e Degës në regjistrin tregtar shqiptar, si dhe regjistrimin e pronarëve përfitues të saj në regjistrin e pronarëve përfitues, në përputhje me legjislacionin shqiptar, duke përfshirë në mënyrë të posaçme autorizimin për të nënshkruar elektronikisht çdo dokument të kërkuar në platformën qeveritare elektronike e-albania për këtë qëllim. ("Përfaqësuesi për regjistrimin në Shqipëri").

Për Ortakun e Vetëm të Shoqërisë

ARTAN LAHAJ
A/L

www.fundway.com